



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Pml.nr.472/224

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Mejreme Memaj dhe Agim Maliqi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit V. F., me vendqëndrim në F., për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, parashikuar me nenin 375 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit, avokatit Festim Shala, paraqitur kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.324/2011 datë 11 mars 2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me 6 gusht 2024, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e mbrojtësit të dënuarit V. F. për mbrojtje të ligjshmërisë, e paraqitur kundër aktgjykimit të formës së prerë Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.324/2011 datë 11 mars 2024.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.324/2011 datë 11 mars 2024, i pandehuri V. F. është shpall fajtor për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, parashikuar me nenin 375 par.1 të KPRK, për të cilën është gjykuar me kusht, ashtu që i është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej njëmbëdhjetë (11) muaj, dhe është urdhëruar që ky dënim mos të ekzekutohet në afat prej dy (2) viteve, me kusht që i pandehuri pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit brenda kësaj periudhe mos të kryejë vepër penale. Konform nenit 375 par.3 të KPRK të pandehurit i është konfiskuar arma-pushka automatike ... prodhim zastava K.- J. me numër serik ..., një karikator, një fishek dhe tetëmbëdhjete gëzhoja.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.733/2023 datë 28 qershor 2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të mbrojtësit të pandehurit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit avokati Festim Shala, për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata

Supreme e Kosovës këto aktgjykime t'i anulojë, ashtu që çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim apo t'i ndryshojë ashtu që ndaj të dënuarit të shqiptohet dënimi me i butë.

Prokurori i Shtetit të Kosovës me shkresën KMLP.II.nr.269/2024 datë 1 gusht 2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, par.1 lidhur me nenin 436, par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

Mbrojtësi në kërkesë nuk konkretizon se cila dispozitë është shkelur, por thekson se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak se arsyetimi është i paqartë, nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme për rrethanat vendimtare në këtë çështje. Pastaj, nuk janë zbatuar drejtë dispozitat e kodit penal dhe procedural-dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit. Gjykata duhet të ketë parasysh qëllimin e dënimit, parimet e përcaktuar me kod si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese lidhur me veprën penale të caktuar ose dënimit. Krahas rrethanave lehtësuese të konstatuara i dënuari ka treguar sjellje të mira dhe paraqitje serioze në raport me gjykatën dhe palët, me parë nuk ka qenë i dënuar dhe është mbajtës i familjes. Në parim praktika gjyqësore e gjykatës evropiane thekson se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se gjykatat duhet të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsye në të cilat ata bazojnë vendimin e tyre.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të lartcekura kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e mbrojtësit janë të pabazuara për këto arsye:

Mbrojtësi me kërkesë i kundërshton aktgjykimet për shkelje esenciale dhe shkelje të ligjit penal, por, nga përmbajtja e kërkesës del se e kundërshton vendimin për dënim me arsyetim se nuk janë dhënë arsye sa i përket dënimit, pa konkretizuar dhe qartësuar këtë pretendim. Sipas dispozitës së nenit 436 par.1 të KPP – me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon, por nuk mund të supozoj se çka dashur të thotë parashtuesi i kërkesës. Sipas dispozitës së nenit 432 të KPP ndaj vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet në rast të shkeljes së ligjit penal, në rast të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 i këtij kodi ose në rast të shkeljeve tjera të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Bazuar në këtë dispozitë vendimi për dënim për të cilën bazë kërkesa është ushtruar nuk ka mundur të kundërshtohet.

Kështu, siç del nga shkresat e lëndës i dënuari në këtë çështje juridiko penale e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe mbrojtësi ka qenë prezent me rastin e pranimit

të fajësisë nga i dënuari. Kurse, në arsyetim të tij gjykata ka dhënë arsye të qarta përkitazi me dënimin e shqiptuar. Vendimi mbi dënimin mund të kundërshtohet me kërkesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase gjykata kur cakton dënim duhet të jep arsye për të gjitha rrethanat të cilat i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit veçanërisht duhet të jep arsye se në cilat shkaqe është bazuar kur ka konstatuar se ka të bëjë veçanërisht me rast të rëndë dhe se duhet shqiptuar dënim me të rëndë se dënimi i paraparë, ose ka konstatuar se është e nevojshme të ulë apo të heqë dënimin, të shqiptojë dënim alternativ ose masën për trajtim të detyruar rehabilitimi ose të konfiskohet dobia pasurore e fituar me vepër penale. Mirëpo, mbrojtësi në këtë drejtim nuk jep arsye, por pretendon se janë nënvlerësuar rrethanat lehtësuese, kurse nga aktgjykimet e kundërshtuara del se gjykatat kane dhënë arsye sa i përket fakteve vendimtare që kanë të bëjnë me dënimin e shqiptuar. Pastaj, është në diskrecion të gjykatës caktimi i llojit dhe lartësisë së dënimit, por a është adekuat apo ne proporcion me peshën e veprës penale dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është çështje që mund të kundërshtohet me ankesë në gjykatën e shkallës së dytë dhe vetëm shkalla e dytë ka diskrecion që ta ndryshoj vendimin në këtë drejtim, por vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të dytë sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit nuk mund të kundërshtohet me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, prandaj pretendimet ne këtë drejtim kjo Gjykatë i konsideron si të pabazuara.

Vendimi mbi dënimin mund të kundërshtohet si shkelje e ligjit penal, por vetëm në rast se gjykatat me rastin e marrjes së vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale kanë tejkuluar kompetencat ligjore, e që paraqet shkelje të ligjit penal (neni 385 par.1 nënpar.1.5 i KPP). Gjykata i tejkalon kompetencat ligjore kur shqipton dënimin i cili nuk mund të shqiptohet nën minimumin e veçantë ose mbi maksimumin apo shqipton lloj tjetër të dënimit i cili nuk mund të shqiptohet për atë vepër penale. Në rastin konkret për veprat penale për të cilat i dënuari është shpall fajtor gjykata ka shqiptuar dënim me kusht, pra, nuk janë tejkuluar autorizimet ligjore.

Nga arsyet që janë theksuar më lart dhe në bazë të nenit 437 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË  
Pml.nr.472/2024, me 6 gusht 2024

Procesmbajtësi,  
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,  
Valdete Daka

